



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.21.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË MINISTRISË PËR
INTEGRIME EVROPIANE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Integrimeve Evropiane, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Florë Berisha (Udhëheqëse ekipi) dhe Riza Spanca (anëtar), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Arvita Zyferi.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| Përmbledhje e përgjithshme | 4 |
| 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm | 6 |
| 2 Qeverisja..... | 9 |
| 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli | 13 |
| Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit | 19 |
| Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA..... | 20 |
| Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak | 23 |
| Shtojca IV: Letërkonfirmimi | 25 |

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Vjetor Financiar të Ministrisë për Integritet Evropian për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 21 tetor 2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë për Integritet Evropian.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Ministren dhe stafin e saj për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Menaxhmentit të MIE-së - auditimi 2016

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë për Integritet Evropian (MIE) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritimit Evropian është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MIE kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013 për shpenzimin e parave publike;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raportet tremujore, përfshirë pasqyrat nëntëmujore;
- Raportet për obligimet e papaguara; dhe
- Plani fillestar dhe final i prokurimit;

Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Çështjet e ngritura në Memorandumin e Auditimit , të datës 15/11/2016, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga menaxhmenti.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në MF, mund të konsiderohet e saktë.

Edhe kërkesat tjera për raportim të jashtëm janë përmbushur në tërësi nga MIE, dhe ne nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MIE që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga MIE siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Menaxhmenti i MIE-së ka bërë përmirësime të theksuara në aranzhimet e qeverisjes së mirë. Gjatë vitit 2016, ka arritur të hartoj regjistrin e rreziqeve kundrejt objektivave të organizatës ku janë përfshirë edhe veprimet e nevojshme për menaxhimin e tyre. Më tutje, MIE kishte bërë progres të theksuar edhe në plotësimin e pyetësorit të vet-vlerësimit në krahasim me vitin e kaluar. Përgjigjet e dhëna korrespondojnë me gjendjen faktike dhe dokumentet mbështetëse konfirmojnë saktësinë e tyre. Për më tepër, menaxhmenti kishte vendosur mekanizma adekuate për tu informuar me kohë lidhur me proceset dhe sfidat të cilat e kanë përcjellë punën gjatë vitit.

Megjithatë, procesi i zbatimit të rekomandimeve ka ende hapësirë për përmirësim. Një pjesë e rekomandimeve të dhëna në raportin e vitit të kaluar nuk janë zbatuar ende. Më tutje, mos-mbajtja e takimeve të rregullta të Komitetit të Auditimit për shqyrtimin e raporteve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm kishte zbehur rëndësinë e kësaj njësie kundrejt mbështetjes së menaxhmentit në arritjen e objektivave.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 për MIE-në ka rezultuar në 13 rekomandime kryesore. MIE kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, nga 13 rekomandimet e dhëna në vitin e kaluar, dhjetë (10) prej tyre janë zbatuar, kurse tri (3) nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraparak - Prioriteti i lartë

E gjetura Ndonëse menaxhmenti ka zbatuar një proces formal të menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), ende nuk kishte arritur që planin e veprimit ta përmbushte në tërësi. Me gjithë progresin e shënuar në këtë drejtim, rekomandimet lidhur me menaxhimin e personelit, menaxhimin e kontratave dhe monitorimin e projekteve të subvencionuara nuk janë zbatuar ende. Si rezultat mangësitë e njëjta ishin përsëritur edhe këtë vit.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të ndikojë në dobësi në menaxhim dhe raportim të shpenzimeve.

Rekomandimi 1 Ministri duhet të sigurojë që në vazhdimësi mbanë llogaridhënës personat përgjegjës të përcaktuar në planin e veprimit me qëllim të zbatimit të plotë të rekomandimeve të AP-së, sipas afateve kohore të përcaktuara.

2.2 Pyetësori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuar në MF, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi. Ne kemi analizuar pyetësorin e vet-vlerësimit dhe kërkesat që dalin prej tij, dhe nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi në këtë proces.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2.1 Proceset e Menaxhimit të rrezikut

Menaxhimi i rrezikut si proces i përgjithshëm i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve dhe zbatimit të kontrolleve të nevojshme për të mbajtur ekspozimin ndaj rrezikut në nivel të pranueshëm është integruar si pjesë e procesit të përgjithshëm të menaxhimit.

Sipas udhëzimeve të përcaktuara me procedurat e MFK-së dhe rregullës 01/2010, të gjitha organizatat buxhetore duhet të hartojnë një regjistrë të menaxhimit të rreziqeve i cili duhet t'i paraprijë procesit të identifikimit të rreziqeve dhe vlerësimit të tyre me qëllim zvogëlimin e rreziqeve në nivel të pranueshëm për të mbështetur një menaxhim efektiv operacional dhe strategjik.

MIE kishte arritur të hartojë regjistrin e rreziqeve në të cilin kishte bërë identifikimin e rreziqeve, mënyrën e menaxhimit dhe njësitë përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MIE operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

MIE ka vendosur kontrolle të brendshme, me qëllim të funksionimit sa më mirë të sistemit financiar dhe të kontrollit. Kontrollet ishin të vendosura në atë mënyrë që përfshinin raportimin e rregullt tek menaxhmenti për të mundësuar një informim me kohë dhe mundësi për përgjigje ndaj sfidave dhe problemeve të raportuara në drejtim të arritjes së objektivave.

Nga rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në këtë fushë, mund të konkludojmë se menaxhmenti ka vendosur një strukturë organizative adekuate, kishte bërë delegimin e detyrave dhe përgjegjësisë dhe ishte informuar për proceset e zhvilluara në kuadër të ministrisë. Departamentet dhe divizionet përgatitin raporte të rregullta në drejtim të Sekretarit të Përgjithshëm, i cili po ashtu organizon takime pune të rregullta me udhëheqësit e njësisë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor i cili është edhe drejtori i NjAB-së. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Njësia ka një plan vjetor të punës të derivuar nga strategjia e auditimit të brendshëm. Qasja e auditimit të brendshëm ishte e bazuar në rreziqe dhe në ngjarjet aktuale të MIE-së. Për periudhën janar-dhjetor 2016 NjAB kishte përgatitur katër (4) raporte të auditimit. Në këto raporte NjAB kishte dhënë rekomandime të cilat ishin të parapara për ta ndihmuar menaxhmentin në vlerësimin e funksionimit të kontrolleve dhe marrjen e vendimeve për korrigjime me kohë. Megjithatë, çështjet e ngritura nga NjAB nuk ishin trajtuar në tërësi për shkak të mosfunksionimit të plotë të Komitetit të Auditimit (KA) gjatë vitit 2016.

Çështja 2 - Mosfunksionimi i Komitetit të Auditimit - Prioriteti i lartë

- E gjetura** UA 11/2010 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të auditimit neni 5, specifikon se KA duhet të mbajë së paku katër (4) takime gjatë një viti. Gjatë vitit 2016 KA kishte arritur të mbante vetëm dy (2) takime. Kjo kishte ndodhur meqenëse kryesuese e komitetit kishte qenë këshilltarja e Ministrisë e cila kishte dhënë dorëheqje në muajin shtator 2016, gjë që kishte pamundësuar të mbahen takime tjera gjatë vitit. Megjithatë, edhe pas emërimit të kabinetit të ri MIE nuk kishte arritur ta formonte komitetin e ri të auditimit.
- Rreziku** Mungesa e takimeve dhe shqyrtimit të raporteve të NjAB-së, si dhe operimi në mungesë të KA-së gjatë vitit, zbeh dukshëm punën dhe vlerën e auditimit të brendshëm. Në këtë mënyrë pamundësohet edhe përcjellja dhe monitorimi i rekomandimeve tek menaxhmenti.
- Rekomandimi 2** Ministri duhet të sigurojë që është formuar në afat sa më të shkurtër Komiteti i Auditimit në bazë të kërkesës ligjore. Duke emëruar një komitet kompetent do t'i ngritej vlera e auditimit të brendshëm dhe do të sigurohej një funksion i mirëfilltë i zinxhirit të kontrolleve të brendshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për shpenzimet në organizatën buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Krahasuar me vitin e kaluar, menaxhmenti i MIE-së ka bërë përmirësime të theksuara në proceset e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Kjo për faktin se, MIE ka arritur t'i eliminoj mangësitë në fushën e prokurimit, në menaxhimin e buxhetit dhe në menaxhimin e shpenzimeve për udhëtime zyrtare të cilat ishin prezentë në vitin paraprak.

Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të Ministrisë. Përkundër masave të ndërmarra, veprime shtesë nevojiten në fushën e menaxhimit të subvencioneve, personelit dhe obligimeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore-realizimi ndaj buxhetit (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final ² | 2016 Realizimi | 2015 Realizimi | 2014 Realizimi |
|----------------------------|-------------------|----------------------------|------------------|------------------|------------------|
| Burimet e Fondeve: | 1,728,534 | 1,628,476 | 1,511,752 | 1,617,905 | 1,591,519 |
| Granti i Qeverisë -Buxheti | 1,728,534 | 1,628,476 | 1,511,752 | 1,617,905 | 1,591,519 |

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 100,058€. Ndryshimi i buxhetit është bërë me rishikim buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2016, MIE ka përdorur 93% të buxhet final ose 1,511,752€, përderisa në vitin 2015 kishte arritur të realizonte 97% të buxhetit. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale si dhe ndryshimet e ndodhura gjatë vitit.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2016 Realizimi | 2015 Realizimi | 2014 Realizimi |
|---|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike: | 1,728,534 | 1,628,477 | 1,511,753 | 1,617,905 | 1,591,519 |
| Pagat dhe Mëditjet | 697,072 | 697,072 | 582,852 | 669,779 | 650,273 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 970,962 | 765,938 | 763,434 | 859,056 | 862,672 |
| Shërbimet komunale | 10,500 | 5,740 | 5,740 | 7,028 | 8,369 |
| Subvencionet dhe Transferet | 50,000 | 159,727 | 159,727 | 82,042 | 70,205 |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti fillestar për paga dhe mëditje nuk kishte pësuar ndryshime gjatë vitit 2016. Në këtë kategori ishte një realizim më i ulët i buxhetit në 84%, për shkak se kabineti kishte dhënë dorëheqje në muajin shtator, dhe mjetet e dedikuara për pagesën e tyre kishin mbetur të pashpenzuara; dhe
- Mjetet në vlerë prej 110,000€ janë transferuar nga kategoria mallra dhe shërbime në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve me kërkesë të MIE-së e cila është mbështetur me vendime të Qeverisë. Pjesa tjetër e buxhetit është shkurtuar me vendim tjetër të Qeverisë për kursime buxhetore. Në kategoritë tjera buxheti ishte realizuar afro 100%.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (Payroll). Kontrollat kyçe që operojnë në MIE kanë të bëjnë me llogaritjen e pagave në pajtim me kontratat e punës si dhe me legjislacionin e aplikueshëm. Numri i aprovuar i të punësuarve në MIE ishte 86, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 68. Ndryshmet në mes të numrit të aprovuar dhe numrit të stafit në fund të vitit, janë si rezultat i dorëheqjes së ministrit në muajin shtator.

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 697,072€ i cili ishte shpenzuar 582,852€. Kemi rishikuar listat e pagave si dhe krahasuar të dhënat e thesarit me PFV. Po ashtu testuam mostra, duke përfshi edhe dosjet e personelit.

Çështja 3 – Mangësi në menaxhimin e personelit – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Rregullorja nr. 06/2012 për emërimet në shërbimin civil përcakton se asnjë pozitë e lartë drejtuese nuk mund të mbahet me Ushtrues Detyre (U.D) më tepër se tre (3) muaj. Gjatë auditimit kemi vërejtur se një (1) pozitë menaxhuese mbahej prej muajit gusht 2015 me U.D. Inicimi i procedurave të rekrutimit për këtë pozitë kishte filluar në gusht 2016, mirëpo ishte anuluar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për shkak të mos respektimit të afateve kohore në bazë të rregullores 02/2010.
- Rreziku** Mbajtja e pozitës me U.D për një kohë të gjatë nuk siguron kryerje të funksioneve me përgjegjësi dhe kompetencë të plotë.
- Rekomandimi 3** Ministri duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin e procedurave të rekrutimit . Procedurat e rekrutimit duhet të fillojnë me kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si U.D të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar me kërkesat ligjore.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 765,938€. Prej tyre ishin shpenzuar 763,434€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me blerje të mallrave, shpenzimeve komunale si dhe udhëtimeve zyrtare. Gjatë auditimit ne kemi testuar 50 mostra të pagesave nga kjo kategori si dhe katër (4) procedura të prokurimit. Nga testimet e kryera nuk kemi evidentuar ndonjë mangësi për t'u theksuar në këtë fushë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 159,727€€. Përfitues të subvencioneve ishin entitetet jo publike. Procesi i menaxhimit të subvencioneve sikurse edhe vitet paraprake ishte përcjell me mangësi.

Çështja 4 - Menaxhimi jo i mirë i subvencioneve - Prioritet i lartë

E gjetura Rregulla financiare 01/2013, neni 36 kërkon që çdo organizatë buxhetore të mbajë regjistra të detajuar të pagesave të subvencioneve dhe transfereve të bëra si dhe kthimeve nga këto pagesa.

Në tri (3) raste në vlerë totale 8,867€, përfituesit nuk kishin ofruar arsyetimin me dëshmi relevante siç janë faturat, raportet financiare, raportet narrative, të cilat do të dëshmonin se subvencioni është shfrytëzuar për qëllimin e dhënë. Kjo kishte ardhur si rezultat i hapësirave në Rregulloren 01/2016 të MIE për subvencionim e projekteve, e cila nuk parasheh që aplikuesit të specifikojnë kohën e realizimit të projekteve me rastin e përfitimit të subvencionit. Për më tepër, as në marrëveshjet e lidhura në mes të MIE-së dhe përfituesve nuk ishte specifikuar koha kur pritet të realizohet secili projekt. Si pasojë MIE nuk ka bazë ligjore për të kërkuar dëshmi nga përfituesit lidhur me realizimin e projektit.

Rreziku Mungesa e raportimit lidhur me zbatimin e projekteve të subvencionuara rrit rrezikun që mjetet të mos shfrytëzohet për qëllimin për të cilin janë dhënë.

Rekomandimi 4 Ministri duhet të marrë veprimet e nevojshme për ta rishikuar rregulloren për menaxhimin e subvencioneve, për të siguruar se përfshinë pikat kyçe të cilat do ta lehtësonin procesin e monitorimit të tyre. Me pas me marrëveshjet individuale duhet të specifikohen detajet për secilin subvencion të dhënë.

Çështja 5 - Pagesa e transferit pa u respektuar procedurat - Prioritet i lartë

- E gjetura** Më datë 01.06.2016, Qeveria kishte aprovuar projektin në mes të MIE dhe UNDP-së në vlerë prej 100,000€ në mënyrë që të dy palët të nënshkruajnë Memorandum Mirëkuptimi, si rezultat i së cilës MIE kishte derdhur mjetet e lartcekura në llogari të UNDP-së.
- Megjithatë në fund të vitit 2016 MIE kishte transferuar edhe vlerën prej 60,000€ në avans për një aktivitet shtesë që do të organizohej më 9 maj (Ditën e Evropës) duke plotësuar memorandumun e mësipërm pa kaluar nëpër procedurat e parapara për marrëveshje ndërkombëtare, pa u aprovuar ndryshimet nga Qeveria.
- Rreziku** Transferimi i mjeteve dhe plotësimi i memorandumit pa kaluar nëpër procedurat e parapara rrezikon që MIE të mos ketë në dispozicion tërë bazën ligjore në rast të realizimit të mangët apo edhe mos realizimit të aktivitetit shtesë të paraparë.
- Rekomandimi 5** Ministri i MIE duhet të sigurojë se para nënshkrimit të marrëveshjeve të tilla, janë respektuar të gjitha procedurat e parapara me kornizën ligjore. Në këtë mënyrë do të sigurohej një bazë e mirë që MIE të zhvillojë aktivitetin e vet duke e ngritur edhe vlerën për para.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuritë neto të MIE-së ishin 121,827€. Prej tyre, pasuritë kapitale (mbi 1,000€) ishin në vlerë 21,565€, vlera e pasurive jo kapitale (nën 1,000€) 60,918€, si dhe vlera e stopeve 39,344€.

Ne kemi testuar pasuritë që rrjedhin nga investimet kapitale gjatë vitit 2016, si dhe rregullsinë në evidentimin e pasurisë në dispozicion. Ne kemi bërë edhe ekzaminimin fizik për të verifikuar ekzistencën e pasurisë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 16,159€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017.

Ne kemi testuar mostra nga obligimet ku kemi analizuar edhe raportet mujore të tyre të dorëzuara në MF/Thesar.

Çështja 6 - Vonesë në pagesë dhe raportim jo i plotë i obligimeve mujore - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas LMFPP neni 29, çdo faturë duhet të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se obligimi i muajit dhjetor për shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit në vlerë 2,449€ ishte paguar 37 ditë pas afatit kohor ligjor. I njëjti obligim nuk ishte raportuar në MF/Thesar në raportin për obligime të muajit janar. Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së kontrolleve në zyrën e financave.
- Rreziku** Mos pagesa në kohë e obligimeve mund të rezultojë me ndëshkime ndaj ministrisë, ndërsa raportimi i mangët i obligimeve pamundëson planifikimin afatshkurtër të tyre.
- Rekomandimi 6** Ministri duhet të sigurojë se obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor në mënyrë që të shmangët ekzekutimi i pagesave drejtpërdrejtë nga thesari. Nëse për ndonjë arsye obligimet mbesin të papaguara, ato duhet të raportohen në Thesar.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

| Komponenti i Auditimit | Rekomandimet e dhëna | Të zbatuara | Në proces të zbatimit | Të pa zbatuara |
|-------------------------------|--|-------------|-----------------------|----------------|
| PFV dhe raportimi | Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive të kontrollit për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF-ve për vitin 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PVF-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme. | Po | | |
| PFV dhe raportimi | Ministri duhet të sigurojë se në planin final të prokurimit përfshihen vetëm ato mallra, punë apo shërbime të cilat planifikohen të kontraktohen përmes procedurave të prokurimit gjatë vitit. Kontrollat të shtuara duhet të ndërmerren edhe në menaxhimin dhe raportimin mujor të obligimeve. | Po | | |
| Rekomandimet e vitit paraprak | Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë afatet kohore dhe zyrtarët përgjegjës, për implementimin e plotë të rekomandimeve. | Po | | |
| Vetëvlerësimi | Ministri duhet të sigurojë se është duke u zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e vlerësimeve të dhëna në listën kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. | Po | | |
| Menaxhimi rrezikut | Ministri duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek zyrtarët përgjegjës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë. | Po | | |

| | | | | |
|--------------------------------------|--|----|--|--------------------|
| Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit | Ministri duhet të sigurojë që në procesin e planifikimit buxhetor të angazhohen aktivisht edhe menaxherët e programeve buxhetore. Ky proces i vlerësimit dhe planifikimit të pasqyrojë tërë informacionin e duhur për nevojat vjetore të pritura, duke marrë në konsideratë parametrat dhe rezultatet paraprake. | Po | | |
| Shpenzimet përmes prokurimit | Ministri duhet të sigurojë që blerjet përmes aneks kontratave të mos tejkalojnë limitin e lejuar nga vlera e kontratës bazë. Rrjedhimisht duhet të vendosen mekanizma shtesë të kontrollit në menaxhimin e kontratave. | Po | | |
| Shpenzimet përmes prokurimit | Ministri duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim për të përcaktuar pse në rastin e mësipërm kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar. Blerjet, përveç rasteve të përjashtuara me legjislacionin përkatës, të realizohen përmes procedurave të prokurimit publik. | Po | | |
| Shpenzimet jo-përmes prokurimit | Ministri duhet të sigurojë se aprovohen vetëm ato trajnime të cilat janë të nevojshme dhe relevante për punën zyrtare të punonjësve. Përveç kësaj, duhet të merret në konsideratë kostoja në raport me përfitimin nga trajnimet e tilla. | Po | | |
| Pagat dhe mëditjet | Ministri duhet të sigurojë se për pozitën e udhëhequr me ushtrues detyre bëhet një zgjidhje e qëndrueshme dhe në pajtim me kërkesat ligjore. | | | Nuk është zbatuar. |
| Pagat dhe mëditjet | Ministri duhet të sigurojë se procesi i përzgjedhjes së kandidatëve që kanë përfunduar programin YCS dokumentohet nga ana e zyrtarëve përgjegjës dhe komisionit vlerësues. | Po | | |
| Subvencionet dhe transferet | Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të shtuar kontrollin, në të gjitha fazat e procesit të subvencionimit të projekteve. | | | Nuk është zbatuar. |
| Trajtimi i obligimeve | Ministri duhet të sigurojë se detyrimet ndaj furnitorëve paguhen me kohë. Nëse për ndonjë arsye borxhet mbesin të papaguara, ato duhet të raportohen në MF/Thesar. | | | Nuk është zbatuar. |

Shtojca IV: Letërkonfirmimi




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Integritimit Evropian
Ministarstvo za Evropske Integracije / Ministry of European Integration

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë për Integritim Evropian për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z.Demush Shasha.....
 Sekretar i Përgjithshëm
 Data: 

Faqe 1 nga 1

Adresa: Ndërtesa e Qeverisë Zyra No. 1411 DK-10-1000 Prishtinë-Kosovë
 E-mail: